



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Arsim / Direkcija za Obrazovanje / Department of Education

Nr.Prot: 38 /2026

Data: 06.02.2026

Në bazë të nenit 78,79, 80 dhe 81 të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.08/L-197, nenit 62 paragrafi 62.3 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 11 paragrafi 2 pika 2.3 i Rregullorës (QRK) nr. 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, nenit 35 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenit 5 pikës c të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, Drejtoria e Arsimit në Skenderaj shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS PËR KOHË TË CAKTUAR

Nr	Niveli	Pozita e nëpunësve të Shërbimit Publik	Kohëzgjatja e emërimit	Fondi i orëve	Numri i pozitive
1	Shfmu	Mësimdhënës/e për Histori dhe Edukatë Qytetare	Kohë të caktuar	Normë e plotë	2

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë – nr 13);
- Rezymeja personale – dosje ; (obligative)
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Diplomat e kualifikimit, **duhet të jenë të vërtetuara ose noterizuara;**
- Certifikatat e noterizuara (certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë jo më të vjetra se gjashtë (6) muaj nga data e diplomimit;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (**nëse ka**).
- **Çertifikata mjekësore duhet të sillet me rastin e nënshkrimit të kontratës.**

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (**Ligji Nr. 03/L-068 dhe Ligji Nr. 04/L-138**), (**UA MASHT Nr.34/2014**) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të **MASHTI-it (UA Nr. 05/2021)** si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

III. Vlerësimi i kandidatëve

- Me këtë konkurs do të zhvillohen procedurat e rekrutimit për vitin shkollor 2025/2026 (Shtator 2025 – Gusht 2026);
- Vlerësimi i kandidatit bëhet bazuar në Rregullorën (QRK) nr. 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërtimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, kapitulli nr VII;
- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave publikohen në webfaqen e <https://kk.rks-gov.net/skenderaj/category/konkursey-njoftimet/> (konkurset);
- Fillimi i punës për vendet e caktuara si me lartë bëhet në varësi të lirimit real të vendit të punës (datës së pensionimit, pushimit të lehonisë etj);
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do të shpallen në web-faqen zyrtare të Komunës të Skenderajt;

IV. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur **5 ditë** nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më: **06.02.2026** deri më datën **10.02.2026** .
- Aplikacioni merret dhe dorëzohet në objektin e komunës, kati i parë, sporteli Nr.13;
- Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim.
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Nëse aplikohet për dy pozita (Vend i lirë/Zëvendësim), kandidatët duhet të dorëzojnë dy aplikacione të veçanta;
- Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse;
- Rezultatet e konkursit do të shpallen në webfaqe të Komunës së Skenderajt.

Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.